ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **205-22-3038-2-1-1**

Nr i brendshëm: **MMPHI 22 033 211**

Sa i përket tenderit për "**HARTIMI I PROJEKTEVE TE NDRYSHME TE RRUGEVE DHE STRUKTURAVE PER VITET 2022-2024**

"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"INFRA PLUS" SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.LUAN HARADINAJ SOL.1 H.1 PRISHTINË; NJËSIA LLAPNASELLË
(Adresa)

PRISHTINË
(Vendi)

10 000
(Kodi postar)

038 60 62 62
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

MUSA ISLAMAJ
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@infraplus-ks.com
(Adresa elektronike)

01.08.2022
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

PROJEKTIM & NDERTIM SH.P.K. Infra - Plus Prishtine CONSULTING & ENGINEERING

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Në bazë te tenderit te publikuar me titull **"HARTIMI I PROJEKTEVE TE NDRYSHME TE RRUGEVE DHE STRUKTURAVE PER VITET 2022-2024"**me NRP **205-22-3038-2-1-1**, ne afatin e rregullt kohor parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim :

11/04/2022 – Njoftim për Kontrate
19/05/2022 – Dorëzimi dhe Hapja e tenderi
13/07/2022 – Njoftim mbi vendimin
13/07/2022 – Kërkese për qasje
15/07/2022 – Qasje e dokumentacionit
18/07/2022 – Kërkesa për Rishqyrtim
21/07/2022 – Vendimi ne kërkesën për rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Me datën 13.07.2022 kemi bere kërkesën për qasje ne dokumente zyrtare pranë Autoritetit Kontraktues derisa përgjigja na është kthyer 21.07.2022 ne baze te vendimit me te cilin Autoriteti Kontraktues nuk e ka marre parasysh argumentet tona për vlerësimin kundërligjor qe është bere ne lidhje me këtë tender. Si rrjedhoje ne i drejtohemi OSHP-se ne mënyrë qe te parandalojmë shkeljen e Ligjeve ne fuqi nga Autoriteti Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit te aktiviteti te prokurimit m titull **Hartimi i Projekteve te ndryshme te Rrugëve dhe Strukturave për vitet 2022-2024**, nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si ne vijim:
Nenin 1 të LPP-së - Qëllimi
Nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Nenin 39.8 te Udhëzuesit Operativ për prokurim publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 13/07/2022 kemi marr Njoftim për Vendimin nga AK Letër Standarde për Tenderuesin e eliminuar për LOT I, Letër Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm për LOT II dhe Letër Standarde për tenderuesin e Suksesshëm për LOT III, dhe me datën 13/07/2022 kemi bere kërkese për qasje dokumentacioni dhe qasja e limituar na është lejuar me datën 15/07/2022, ku dhe gjate qasjes se dokumentacionit për kompanitë fituese për LOT I nuk na u është lejuar ne gjithë dokumentacionin me arsyetimin se kompania fituese ka paraqit **"Aneksi 3. KËRKESA PËR KONIDENCIALITET"** dhe duke u bazuar ne dokumentacionin për kompaninë e rekomanduar për kontrate nga AK dhe duke u bazuar për pretendimet tona mbi arsyet e eliminimit si me poshtë:

ARSYETIM - *Ju jeni eleminuar* - për këto arsye :
LOT 1 është kërkuar 1. Menaxheri i Projektit (Projektuesi Kryesor) - Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, të këtë së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, dhe te ketë menaxhuar minimum 1 (një) projekte në pozitën e Menaxherit të Projektit në Projektimin e Rrugëve. **I mungon një menaxher i projektit**
3. Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë me tri (3) vite përvojë pune, , ose Inxhinier i Gjeodezisë me së paku pese (5) vite përvojë ose Bahchelor i diplomuar i gjeodezisë me së minimum pese(5) vite përvojë pune pas diplomimit. Përvoja për këtë staf duhet të jetë në lëmin e punëve gjeodezike në Projektet e projektimit të rrugëve. **I mungon një gjeodet**
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar ne Nenin I të këtij Njoftimi për dhënie të kontratës.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Prandaj duke pas parasysh shkeljet ligjore te cilat Autoriteti Kontraktues ne kemi bere kërkesë për rishqyrtim te cilën kërkesë Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar dhe si rrjedhojë ne paraqesim pretendimet tona si me poshtë:

Pretendimi 1

ARSYETIM - *Ju jeni eleminuar* - për këto arsye :
LOT 1 është kërkuar 1. Menaxheri i Projektit (Projektuesi Kryesor) - Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, të këtë së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, dhe te ketë menaxhuar minimum 1 (një) projekte në pozitën e Menaxherit të Projektit në Projektimin e Rrugëve. **I mungon një menaxher i projektit**

Ne si OE ne dosjen e tenderit te dorëzuar nga ana jone janë te plotësuar kërkesat për dy lot-e , pra janë dyfishuar stafi ku i plotësojmë kushtet për te dy lot-e mirëpo kemi aplikuar ne te tri Lot-et , duke përfshire gjithashtu menaxherin e projektit , neve kemi bere vendimin për dy menaxher Niman Dreshaj dhe Veton Pira , ku thuhet se : "**Ing. Dpl. – Ndërtimtarisë-Konstruktiv – Niman DRESHAJ** dhe **Ing. Dpl. – Ndërtimtarisë-Konstruktiv – Veton PIRA** do të jenë **Projekt Menaxher** gjatë realizimit të kontratës e lartshënuar , respektivisht ne LOTET qe do te ju caktohen për LOT / LOT-et." kjo nënkupton se për dy LOT-e i plotësojmë kërkesën për menaxher projekti, dhe qe te dy menaxher-at qe kemi dorëzuar janë plotësisht te kualifikuar duke u bazuar ne kërkesat tuaja , pasi qe te stafin qe kemi dorëzuar kane dhe dëshmi te mjaftueshme për përvojën e tyre.
Sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktues ne kemi plotësuar te dy kërkesat për secilin LOT veç e veç kështu qe AK-ja ne këtë rast na ka diskriminuar haptas ne dem te kompanisë sonë dhe e ka favorizuar ne kundërshtim me ligjin e prokurimit një Operator te caktuar ekonomik.

Autoriteti Kontraktues ne vendimin për hedhjen e kërkesës për rishqyrtim e ka arsyetuar vendimin se "për tu shpërblyer me shume se një LOT duhet te plotësohen kapacitetet profesionale për aq LOT sa konkurroni" dhe me tej thotë "OE ka pranuar se ka konkurruar ne tri LOT por ka ofruar staf për dy LOT"
Autoriteti Kontraktues ne kundërshtim me Ligjin e Prokurimit ka pretenduar se nëse ne si OE nuk i plotësojmë për te tri L:OTET nuk mund te kualifikohemi për dhënie te kontratës. Fakti është se ne i kemi plotësuar kriteret për dy LOT e ku me këtë fakt pajtohet edhe AK-ja por jemi shpërblyer me vetëm një LOT. Kjo është bere ne kundërshtim me Ligjin e Prokurimit dhe me UOPP.

Pretendimi 2

3. Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë me tri (3) vite përvojë pune, , ose Inxhinier i Gjeodezisë me së paku pese (5) vite përvojë ose Bahchelor i diplomuar i gjeodezisë me së minimum pese(5) vite përvojë pune pas diplomimit. Përvoja për këtë staf duhet të jetë në lënin e punëve gjeodezike në Projektet e projektimit të rrugëve. **I mungon një gjeodet**

Ne pretendimin tone te radhës tek inxhinieri i gjeodezisë , neve e kemi ne liste Jetmir Avdiaj dhe Ilmi Zherka, dhe qe janë plotësisht te kualifikuar për te gjitha Lot-et e sidomos për LOT I, ku Jetmir AVDIAJ ka dëshmi për përvojën qe nga viti 2010 është pjese e kompanisë sonë Infra Plus dhe qe ka menaxhuar te gjitha projektet ne sektorin e gjeodezisë qe nga viti 2010, gjithashtu ku është dhe e dëshmuar dhe me referenca dhe një numër te madhe te projekte te rrugëve te të gjitha llojeve.
Autoriteti Kontraktues e ka marre përgjegjësinë qe te vendos pa i shfrytëzuar mekanizmat ligjore qe ja lejon Ligji i Prokurimit dhe UOPP qe te kërkojë sqarim se për cilin LOT janë te emërtuar stafi dhe ka vendosur ti pozicionoje vet ne LOT qe ju konvenon komisionit te vlerësimit me te vetmin qellim qe ne te diskriminohemi dhe te njëjtën kohe te favorizohet një operator i caktuar ekonomik i cili është ne LOT 1 dhe i cili ka ofruar ofertën me te shtrenjte për 50% se oferta jone dhe për te cilin nuk na është dhënë qasje ne dokumente e për te cilat ne jemi te sigurt se nuk i posedon për kualifikim e lere për shpërblim me kontrate.

Me këtë rast Autoriteti qëllimisht ka realizuar vlerësim subjektiv ne dem tonin si pale me interes material dhe se çudit fakti se për LOT I jemi eliminuar me pretekstin se nuk i plotësojmë kërkesat e dosjes se tenderit por qe me një vlerësim te thjeshte dëshmohet se AK-ja ka qene subjektive dhe se nuk mund te ekzistoje fakti se ne vetëm për një LOT nuk i plotësojmë kushtet tjera.

Pretendimi 3

Autoriteti Kontraktues ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate ka përdor dosjen e tenderit për kontrate publike kornize – Shërbim – me disa operator ekonomik e cila ne baze te UOPP

56.33 Kurdo që Autoriteti kontraktues planifikon që të lidhë kontratë publike kornizë me disa Operator Ekonomik ai duhet të përdor llojin e (b) kontratës publike kornizë – **NUK i vendos të gjithë termat dhe kushtet.**

b) Me shume se një Operator ekonomik. Ne kete rast, duhet te jene se paku tre **Operator Ekonomik** palë në kontratën publike kornizë. Në rast se jo të gjithë Operatorët Ekonomikë që janë palë të Kontratës Publike kornize dorëzojnë ofertat e tyre, procedura e mini-tenderimit do të jetë e vlefshme.

Do të thotë AK duhet:
a) te ketë se paku 3 Operatore ekonomik palët të kontratës publike kornize;
b) te ftoj të gjithë Operatoret Ekonomik pale të kontratës publike kornize; dhe
c) ne rast se vetëm një OE dorëzon oferte, të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues ne kundërshtim me UOPP ka shpërblyer me një kontrate Operatoret Ekonomik pjese te procedurës dhe për me tepër duke vendosur te gjitha kushtet te cilat është dashur te përdoren ne procedure tjetër te prokurimit. Kjo është bere duke shkelur Ligjin e Prokurimit Publik dhe UOPP dhe duke mos respektuar procedurat.

Për me tepër Autoriteti Kontraktues ne kundërshtim me nenin 56.15 (shih poshtë) te UOPP nuk ka përcaktuar peshën e secilit pozicion duke lënë hapësirë për manipulime nga ana e Operatoreve Ekonomik qe kane qasje ne te dhëna qe janë sensitive për këtë projekt.

56.15 Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, ***kontratat me çmime për njësi***, AK duhet të përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët.

Përfundim:
Ne si Operator Ekonomik ne baze te pretendimeve tona te bazuara ne dokumentet pjese te procedurës se tenderimit vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te neneve te përshkruara ne paragrafin 7 te kësaj ankese dhe qëllimshëm ka interpretuar faktet ne dem te një ose me shume Operatoreve Ekonomik duke favorizuar një Operator te caktuar dhe duke diskriminuar Operatoret tjerë. Për me tepër Autoriteti Kontraktues me shkeljet ligjore ne këtë procedure do ti shkaktoje dëme financiare vet AK-se dhe se bashku edhe Buxhetit te Kosovës duke shpërblyer oferta dukshëm me te larta se ato te ofruara dhe te dyshimta se si do te realizohen duke pas parasysh se nuk dihet qarte se cili pozicion sa do te shfrytëzohet.

Prandaj bazuar ne pretendimet tona dhe duk pas parasysh demin e shkaktuar buxhetit te Autoritetit Kontraktues kërkojmë qe te anulohet njoftimi për vendim i datës 13.07.2022 dhe tenderi te ***ANULOHET*** *ne tërësi.*

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet financiare ne rast se vendimet nuk korrigjohen janë jashtëzakonisht të mëdha dhe do te vlerësohen ne kërkesën për kompensim, por dëmi me i madh i bëhet konkurrencës se ndershme dhe të drejtë, poashtu dëmi më i madh i shkaktohet buxhetit te Autoritetit Kontraktues.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.